



Datë: 29.04.2025
Numër Protokolli: 3006/2025

A.nr. 410/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.410/2025 të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi M.V, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Labinot Gashi nga Peja, kundër organit të punësimit: Komuna e Pejës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ***shpallet jo kompetent*** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.410/2025, të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi M.V.
- II.** Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi M.V, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 27.02.2025, përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë 03.03.2025 dhe regjistruar nën shenjen A.nr.410/2025, kundër Vendimit me numër protokolli Nr: 01-112/01-7354 të datës 03.02.2025, të Komisionit për Zgjidhjen e Konteksteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës, si dhe Njoftimit me numër protokolli Nr:01-112/01-0085703/2024 të datës 26.12.2024, të Njesisë së Personelit të Komunës së Pejës, lidhur me publikimin e rezultateve përfundimtare sipas Konkursit për pranim me Nr.prot.01-112/01-0085703/24 të datës 17.10.2024, për pozitën e punës Doktor i Stomatologjisë, të shpallur nga Komuna e Pejës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës ***nuk është kompetent*** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.410/2025, të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi, ***sepse:***

Nga provat e çështjes rrjedhë se Komuna e Pejës, më datë 17.10.2024, ka publikuar Konkursin për pranim me numër protokolli Nr.01-112/01-0085703/24, për grupin Specialistë i Shëndetësisë/Mjekësisë, për

pozitën e punës Doktor i Stomatologjisë, dhjetë (10) vende të lira pune, në Sektorin e Shëndetit Oral, me afat aplikimi nga data 18.10.2024 deri më datën 16.11.2024.

Në konkursin përkatës të punësimit ka aplikuar edhe ankuesi dhe se i njëjti nuk është përfshirë në listën e ngushtë të kandidatëve, ndërsa, më datë 26.12.2024, Njësia e Personelit të Komunës së Pejës, ka publikuar Njoftimin me numër protokoli Nr:01-112/01-0085703/2024, lidhur me shpalljen e kandidateve të suksesshëm për pozitën e kontestuar.

Ankuesi më datë 16.01.2025 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Konteksteve dhe Ankesave pranë Komunës së Pejës, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër protokoli Nr: 01-112/01-7354, të datës 03.02.2025, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit, duke lënë në fuqi Njoftimin me numër protokoli Nr:01-112/01-0085703/2024, të datës 26.12.2024, për shpalljen e kandidatëve fitues.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, Shkeljeve të dispozitave materiale të ligjit të punës, vërtetimit të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkeljeve të tjera procedurale. Kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj procesin e rekrutimit për pozitën Doktor të Stomatologjisë, si dhe të gjitha njoftimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit në pikëpamje lëndore, Kolegji i Këshillit i`u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 përcaktohet se: 1. Kategoritë e zyrtareve publik janë: 1.1. *Nëpunës i shërbimit civil*; **1.2. Nëpunës i shërbimit publik**; 1.3. *Krijues dhe performues i artit dhe kulturës*; 1.4. *Nëpunës teknik dhe mbështetës*; dhe 1.5. *Zyrtar i kabinetit*. **2. Nëpunës i shërbimit civil** është zyrtari publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunës i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e drejtuesit të lartë, në administratën e Presidentit të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunësi statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. **3. Nëpunës i shërbimit publik** është zyrtari publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, **shëndetësisë**, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësi i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësi i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e Komunës. Rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton fakti se të gjithë të punësuarit duke përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike shëndetësore të Republikës së Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik, kështu që, edhe pozita Doktor stomatolog, është pozitë profesionale në fushën e mjekësisë dhe si e tillë kategorizohet në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik.

Nisur nga konstatimi së procedura e kontestuar e pranimit, nuk ka të bëjë më pozitën e nëpunësit civil, atëherë, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.410/2025 të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi M.V.

Lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), Kolegji i Këshillit ve në dukje përcaktimet ligjore sipas nenit 77 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë, ku përshihet se: *1.Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësin/in e shërbimit publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës, e në ndërlidhje me këtë, Ligji Nr. 03/L-212 i Punës përkatësisht me nenin 78 dhe 79 ka rregulluar: Neni 78, paragrafi 1 ” 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.*

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion apo kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me ankesën dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi ka parashtruar ankesë të brendshme pranë organit të punësimit, përkatësisht tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, pala ankuese udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente, pasi që lënda nuk mund të bartet të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.410/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar, Avokat Labinot Gashi;
- Njësisë për Burime Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;